



04-12-2019

Frishtinë / Pristina

Nr. 106/1888-2019



Në bazë të autorizimeve të përcaktuara me nenin 64 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë dhe me nenin 8 të Rregullës së KQZ nr. 01/2013 mbi Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me datë 04.12.2019, merr këtë:

### V E N D I M

#### për largim nga regjistri i partive politike të partisë politike Partia Nacional Demokratike Shqiptare

- I. Për mos aplikim për certifikim KQZ-ja për të marrë pjesë në tri palë zgjedhje të njëpasnjëshme, partia politike 'Partia Nacional Demokratike Shqiptare', me akronimin PNDSH, e regjistruar më 21 gusht 2000 largohet/çregjistrohet nga regjistri i partive politike.
- II. Kryetari dhe organet drejtuese të partisë politike 'Partia Nacional Demokratike Shqiptare- PNDSH', edhe pas marrjes së vendimit për çregjistrim nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, vazhdojnë të mbesin përgjegjës për të gjitha të obligimet e krijuara gjatë periudhës së të qenurit aktiv.
- III. Obligohet Zyra që ta njoftoj përfaqësuesin e partisë politike 'Partia Nacional Demokratike Shqiptare- PNDSH', për marrjen e këtij Vendimi dhe që ta largoj të njëjtën nga Regjistri i Partive Politike.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me datën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Në bazë të Rregullës Zgjedhore 01/2013 për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, në lidhje me Çregjistrimin e partive politike nga regjistri i partive të regjistruara, në germën c) të nenit 8 theksohet se: 'Me vendimin e KQZ-së, Zyra e fshin nga regjistri i partive politike, nëse: ... c) nuk është certifikuar nga KQZ-ja për të marrë pjesë në tri pale zgjedhje të njëpasnjëshme.' Partia politike, 'Partia Nacional Demokratike Shqiptare- PNDSH' nuk rezulton të jetë e certifikuar për të marrë pjesë në të paktën tri palë zgjedhjet e fundit (2014, 2017, 2019), as si parti politike në vete dhe as si pjesë e ndonjë koalicioni parazgjedhor, dhe si e tillë kualifikohet për t'u fshirë nga regjistri i partive politike të regjistruara.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Republika e Kosovës  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Valdete Daka, Kryetare

**Këshillë juridike:** Kryetari i partisë politike, 'Partia Nacional Demokratike Shqiptare- PNDSH', z. Bujar Abdullahu, ka të drejtë ankese në Panelin Zgjedhore për Ankese dhe Parashtrës – PZAP, brenda 24 orëve nga pranimi i këtij vendimi të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për çregjistrim nga regjistri i partive.